

... të fëmijëve në transmetime  
... esën e Autoritetit të Med  
... ive që prej muajit prill ka  
... tur më **Buletini i** shumë  
... mendime **Lëshillit të** për  
... cilave kanë **Ankesave.** N  
... të drejtë të kërkojë, të het  
... të marrë dhe të ndajë info  
... dhe ide, pa asnjë lloj censu  
... dios, tu dhe mjeteve të tjer  
... ikimit audioviziv apo ndor  
... tjetër bazuar në përzgjed  
... m nëse këtë e bën në kuad  
... timit të sundin  
... tave të njeriut. **MM**  
... me krijimin e shërbimeve



# *Dërbajtja*

Hyrja .....	04
Procesi i trajtimit të ankesave nga Këshilli i Ankesave .....	06
<b>SEKSIONI I</b>	
Ankesa me objekt "Cënimin e rregullave të etikës dhe dinjitetit".....	09
<b>SEKSIONI II</b>	
Ankesa me objekt "Cënimin e të drejtave të fëmijëve".....	17
<b>SEKSIONI III</b>	
Ankesa të rrëzuara .....	22
<b>SEKSIONI IV</b>	
Ankesa me objekt jashtë juridiksionit të AMA-s .....	25

*Dy fjalë*

*në vend të hyrjes*

Në katër muajt e parë të vitit 2022 ankesat e mbërritura në adresë të Autoritetit të Mediave Audiovizive nuk janë trajtuar nga Këshilli i Ankesave, por nga strukturat e tjera përbërëse të AMA-s, si Drejtoria e Programeve, për shkak të përfundimit të mandatit të kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit të Ankesave në dhjetor të vitit 2021.

Në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Këshilli aktual i Ankesave ka përgatitur një buletin të ankesave të trajtuara nga Autoriteti i Mediave Audiovizive në periudhën janar – prill 2022, kohë kur struktura e KA-së nuk ishte funksionale.

Përgjatë këtyre muajve, fokusi i ankesave të mbërritura në AMA i referohej më së shumti cenimit të dinjitetit e të drejtave themelore të njeriut, duke prekur në mënyrë të veçantë mbrojtjen e të miturve si dhe kërkesat për respektimin e normave morale dhe etike në programet e ofruesve të shërbimeve audiovizive.

Ankesat u trajtuan bazuar në Ligjin për Mediat Audiovizive, Kodin e Transmetimit si dhe në rregulloret e miratuara nga AMA. Vlen të theksohet se edhe në këtë buletin, ankesat janë adresuar nga individë, organizata të shoqërisë civile dhe institucione të ndryshme.

## Procesi i trajtimit të ankesave nga Këshilli i Ankesave

Mbështetur mbi Ligjin nr. 97/ 2013 për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë dhe Kodit të Transmetimit, shikuesit dhe dëgjuesit e subjekteve audiovizive kanë të drejtën të ankohen rreth përmbajtjes së transmetimeve audiovizive, nëse ata besojnë dhe mendojnë që subjektet kanë cenuar apo shkelur parimet dhe rregullat etike, të hartuara në Ligjin Nr. 97/2013 dhe ato në Kodin e Transmetimit.

Por që të mund të ngrihet një ankesë duhet të identifikohet më parë programi apo emisioni, të cilit ankesa i referohet, duke përfshirë datën dhe kohën e transmetimit. Gjithashtu, ankuesi duhet të shpjegojë se çfarë cenimi/shkelje ka vërejtur në përmbajtjen e programit që e ka detyruar atë të ngrejë një ankesë.

Është shumë e rëndësishme të përcaktohen qartësisht argumentet e një ankesë dhe përse materiali programor apo përmbajtja komerciale nuk pajtohet me parimet, rregullat, kërkesat dhe praktikën e përcaktuara në Ligjin nr. 97/2013 dhe në Kodin e Transmetimit. Ligji për mediat audiovizive dhe Kodi i Transmetimit mund të gjenden në faqen zyrtare të AMA-s: [www.ama.gov.al](http://www.ama.gov.al).

Në një nga seksionet e kësaj faqeje, pasi të klikoni në rubrikën "**Formular ankesë për shkeljen e Kodit të Transmetimit**", plotësoni formularin me të dhënat që kërkohen ose mund të shkruani në adresën zyrtare të AMA-s: [info@ama.gov.al](mailto:info@ama.gov.al). Në përputhje me procesin e ankimit, shikuesi apo dëgjuesi duhet të dërgojë ankesën në adresën që gjendet në fund të fletës së ankesës, pasi ka lexuar me kujdes udhëzimet për hartimin e saj, por mbi të gjitha parimet dhe rregullat e Kodit të Transmetimit.

Në disa raste, publiku vetë mund t'ua drejtojë OSHMA-ve ankesat që ai harton, kur e mendon se kjo është një rrugë më e shpejtë dhe që subjekti mund të reflektojë. Kur shikuesi apo dëgjuesi nuk mbetet i kënaqur me përgjigjen nga transmetuesit ose, nëse transmetuesi nuk përgjigjet, atëherë ai mund ta referojë ankesën e tij në Këshillin e Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, në faqen e tij zyrtare ose me postë.

Sa i përket trajtimit të ankesës, Këshilli i Ankesave në shqyrtimin e çdo ankesë që i mbërrin, bazohet mbi kodet dhe rregullat përkatëse në ligj, në materialin e shkruar të paraqitur nga palët përkatëse, si dhe materialin e transmetimit. Ankesat shqyrtohen në nivel ekzekutiv nga Këshilli i Ankesave, në bashkëpunim me drejtorinë e tjera të AMA-s, si Drejtoria e Programeve, Drejtoria Juridike dhe ajo e Mbikëqyrjes.

Detajet e shqyrtimit dhe vendimet mbi ankesat për përmbajtjen e transmetimeve audiovizive të marra nga Këshilli i Ankesave janë publikuar në këtë dokument, i cili quhet **Buletini i Këshillit të Ankesave**. Vendimet merren mbi çështjen, nëse një program apo një komunikim tregtar ka apo nuk ka respektuar kërkesat përkatëse ligjore dhe rregullat e Kodit të Transmetimit. Vendimet nuk lidhen me miratimin apo përkrahjen që mund t'u bëhet palëve në ankesë dhe gjithashtu ato nuk vijnë si rezultat i trajtimit të çdo aspekti të detajuar që përmban vetë ankesa. Këshilli i Ankesave nuk kryen asnjë vlerësim të veçantë apo të pavarur jashtë çështjeve të parashtruara në ankesë.



Ankesa me  
objekt  
"Cënimin e  
rregullave  
të etikës  
dhe dinjitetit"

Ankesa e paraqitur nga: **Organizata "Drejtësi Sociale"**

Subjekti audioviziv	Programi	Data
TV "RTSH 1"	Emisioni "Zëri i Popullit"	28.12.2021

### 1. Përmbledhje e Ankesës

Përfaqësues të organizatës, "Drejtësi Sociale", i drejtuan një ankesë Autoritetit të Mediave Audiovizive në lidhje me emisionin "Zëri i Popullit", transmetuar në televizionin "RTSH 1" më datë 19.12.2021. Ankuesit pretendonin se gjatë emisionit, në orën 19:44, "nga një "qytetar" në telefon, përdoret shprehja "merr flakë si pushka e jevgut".

### 2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Autoriteti i Mediave Audiovizive, AMA, pasi mori ankesën nisi menjëherë procesin e shqyrtimit të saj, bazuar në ligjin nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ku identifikoi se gjatë emisionit "Zëri i Popullit", datë 19.12.2021 nuk ishin respektuar kërkesat e Kodit të Transmetimit. Në orën 19:44 ishte përdorur një shprehje diskriminuese për komunitetin egjiptian, krejt e papërshtatshme për përmbajtjet që transmeton një OSHMA, aq më tepër kur bëhet fjalë për një televizion publik kombëtar. Televizioni në fjalë ishte në shkelje të kërkesave të Kodit të Transmetimit, konkretisht të Seksionit 1 (Parimet Themelore) pikat 1.1 dhe 1.12. Sa më sipër, AMA i tërhoqi vëmendjen operatorit audioviziv duke kërkuar ndërprerjen e praktikave të tilla; në të kundërt do të fillohej procedimi, bazuar në legjisllacionin në fuqi.

Ankesa e paraqitur nga: **E.Q**

Subjekti audioviziv	Programi	Data
Televizione Portale	Edicione informative Shkrime	14.01.2022 14.01.2022

### 1. Përmbledhje e Ankesës

Shtetasja E.Q i drejtoi një ankesë Autoritetit të Mediave Audiovizive, duke pretenduar, se në datën 07.01.2022 media kishte transmetuar një lajm të shoqëruar me gjeneralitetet dhe foton e saj. Ankuesja pretendonte se "foto ime është (keq)përdorur për të identifikuar një nga personat e arrestuar, që quhet E.Q, që thuhet se është specialiste e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI)". Ankuesja u kërkoi disa institucioneve, mes tyre edhe AMA-s, ndërhyrjen zyrtare "për heqjen e të gjitha fotove nga portalet e ndryshme zyrtare dhe jozyrtare, si dhe të zëvendësohet fotografia ime nga fotografia e personit të vërtetë të kryerjes së krimin, për të cilin akuzohet mediatikisht, të sqarohet situata me një deklaratë me shkrim për mediat dhe për burimet e mediave online".

### 2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Pasi shqyrtoi materialet e ankesës dhe përmbajtjet audiovizive të operatorëve audiovizive gjatë edicioneve informative, AMA konstatoi se mbulimi i ngjarjes ishte bërë përmes ekspozimit të fotos së ankueses në një kontekst tjetër. Lidhur me vijimin e mëtejshëm të procedurave të ankesës, AMA i bëri me dije ankueses se ishte duke pritur një reagim zyrtar nga institucionet që kishin trajtuar dinamikën e rrjedhjes së informacionit përkitazi pagave, si dhe paraqitjen në media të fotos personale në identitetin e një tjetër personi; çështje të cilat vijnë të jenë në procedurë të ndjekjes ligjore. Sa më sipër, AMA në vendimin e saj, i sqaroi ankueses se institucioni do t'i kërkojë menjëherë subjekteve audiovizive të licencuara, korrigjimin e fotos së saj

me identitetin e personit tjetër. Ndërkohë i bëri me dije asaj se bazuar në ligjin nr.97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, përmbajtjet e publikuara në portale nuk janë në juridiksionin e AMA-s.

Ankesa e paraqitur nga: **Studio ligjore "Shehu & Partners"**

Subjekti audioviziv	Programi	Data
TV "Top Channel"	Emisioni "Top Story"	15.01.2022

### 1. Përmbledhje e Ankesës

Studio ligjore "Shehu & Partners", si përfaqësuesi zyrtar i shtetasit G.B, i drejtuan një ankesë Autoritetit të Mediave Audiovizive lidhur me transmetimin e emisionit "Top Story", datë 12 janar 2022, në televizionin "Top Channel". Ankuesi pretendonte se në përmbajtjen e emisionit kishte shpifje dhe shpërndarje të paautorizuar dhe të kundërligjshme të të dhënave personale të klientit të tij.

### 2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Pas marrjes së ankesës, Autoriteti i Mediave Audiovizive nisi shqyrtimin e përmbajtjes audiovizive, ku fillimisht bazuar në nenin 51 të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, rregullores "Mbi procedurat për shqyrtimin e ankesave nga Këshilli i Ankesave dhe të drejtës së përgjigjes", si dhe udhëzimit "Mbi procedurat e trajtimit të ankesave nga Ofruesit e Shërbimit Mediatic Audioviziv" i kërkoi OSHMA-së paraqitjen e pretendimeve lidhur me materialin. Në kuadër të trajtimit sa më profesional dhe të drejtë të ankesës, AMA i kërkoi mendim të specializuar edhe Komisionerit Për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Pas mbledhjes së informacioneve dhe shqyrtimit të materialeve përkatëse, AMA iu përgjigj ankuesit se përmbajtja e transmetuar në thelb i jepej publikut në formatin e investigimit gazetaresk. Mënyra e paraqitjes së fakteve, përmes prezantimit të dokumenteve me shpjegimet përkatëse, nuk identifikonte vërtetësinë apo pavërtetësinë e pohimeve gjatë prezantimit të investigimit. AMA e sqaroi ankuesin lidhur me pretendimin e tij "se në përmbajtjen e emision-

*it kishte shpifje nga realizuesit e emisionit" se verifikimi i dokumentacioneve zyrtare të bëra publike nga mediat nuk është në tagrin e Autoritetit të Mediave Audiovizive por kërkon një proces hetimor profesional, që mund të kryhej vetëm nga institucionet e ngarkuara me ligj për procedime të tilla. Bazuar në sa më sipër, AMA i kërkoi OSHMA-së që ankuesi të ushtrojë të drejtën e përgjigjes, bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.*

Edhe pas kësaj procedure, ankuesi drejtoi sërish një ankesë, ndërkohë që AMA i bëri me dije se do të shprehej për çështjen vetëm pas vendimeve të institucioneve kompetente përkatëse lidhur me pretendimin e tij se emisioni kishte publikuar të pavërteta.

Ankesa e paraqitur nga: **Ankues**

Subjekti audioviziv	Programi	Data
TV Klan	Emisioni "Love Story 2"	22.02.2022

### 1. Përmbledhje e Ankesës

Autoriteti i Mediave Audiovizive, AMA, mori një ankesë për përmbajtje të papërshtatshme gjatë transmetimit të emisionit "Love Story 2", datë 22.02.2022.

### 2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Pas trajtimit të ankesës, bazuar në ligjin nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, AMA evidentoi gjatë emisionit diskutime joetike, shpesh të nxitura dhe nga pyetjet e moderatorit. Autorët e emisionit nuk kishin marrë parasysht edhe faktin se përmbajtja transmetohej në një orar kur mendohet se fëmijët janë para ekranit. Edhe në fund të vitit të kaluar (2021) AMA i kishte tërhequr vëmendjen subjektit audioviziv përkatës për transmetim të përmbajtjeve të papërshtatshme në këtë emision. AMA i sugjeroi Drejtorisë së Programacionit të OSHMA-së që "Nëse formati i "Love Story 2" përfshin trajtimin e temave të tilla, atëherë autorët mund të zhvendosin transmetimin në mbrëmje vonë, në një kohë të përshtatshme, duke e shoqëruar me sinjalistikën e nevojshme, si mbrojtje për ndjekësit potencialë të mitur". Në të njëjtën kohë i bëri thirrje subjektit audioviziv të respektojë kërkesat e ligjit 97/2013, i ndryshuar, sipas të cilit OSHMA-të gjatë zhvillimit të veprimtarisë së tyre, udhëhiqen edhe nga parimi i "moslejimit të transmetimeve që nxisin intolerancën ndërmjet shtetasve", (neni 4, pika 2, germa "d"); si dhe "të mos cenojë dinjitetin dhe të drejtat themelore të njeriut", (neni 33, pika 1, germa "ç"). Për sa më sipër, AMA i tërhoqi sërish vëmendjen operatorit TV Klan, për mospërsëritjen e praktikave të tilla duke i rikujtuar se në rast të kundërt do të niste procedimin, bazuar në legjislacionin në fuqi.



Ankesa e paraqitur nga: **Ankues**

Subjekti audioviziv	Programi	Data
<b>Report TV</b>	<b>Emisioni "Pa gjurmë"</b>	<b>23.03.2022</b>

### 1. Përmbledhje e Ankesës

Autoriteti i Mediave Audiovizive, AMA, mori një ankesë për emisionin "Pa gjurmë", transmetuar në datën 21.03.2022, në orarin 15:33–16:40. Ankuesja pretendonte se gjatë këtij programi, J.N, ka treguar me hollësi gjithë jetën bashkëshortore duke përmendur me emër e mbiemër shumë familjarë të ish –bashkëshortes si edhe duke thënë shumë fjalë fyese për ta. Sipas ankueses gjatë këtij programi në sfond shfaqen herë pas here fotografi të ndryshme të fëmijëve.

### 2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Pas shqyrtimit të përmbajtjes audiovizive, AMA identifikoi shkelje të kërkesave të ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe të Kodit të Transmetimit. Personi i ftuar në emision, i divorcuar prej vitesh, kishte treguar episode të shkuara nga lidhja martesore dhe pjesëtarë të familjes, duke përmendur të dhëna personale, ilustruar dhe me fotografi. AMA e vlerësoi të drejtë ankesën përkitazi publikimit pa autorizim të detajeve nga jeta familjare. Në nenin 4 të ligjit 97/2013, saktësohet se një prej parimeve themelore për veprimtarinë e transmetimeve audiovizive është dhe "respektimi e garantimi i së drejtës së ruajtjes së jetës private", (pika 2 "ç"). Kurse në nenin 33, po aty, pika 1 "dh", kur flitet për detyrimet e subjekteve audiovizive, përmendet dhe se, ato nuk duhet të cenojnë cenonjë "të drejtën e fshehtësisë së jetës private të individit në çdo program të transmetuar nga OSHMA-të dhe mjetet e përdorura për të realizuar këto programe." Në seksionin 3 të Kodit të Transmetimit, pika 3.1, saktësohet se:

*"Shpërndarja e informacionit tek publiku, duke përfshirë këtu edhe fotografitë për jetën private të individëve pa pëlqimin e tyre, është e pranueshme vetëm nëse një interes i ligjshëm publik tejkalon të drejtën e tyre për privatësi ose kur materiali në fjalë duhet të publikohet në interes të publikut, duke e tejkaluar të drejtën e privatësisë. Gazetari duhet të sigurohet, për të zbatuar standardet më të larta profesionale që informacioni i dhënë të jetë i saktë, i paraqitur në mënyrë të drejtë dhe objektive, veçanërisht kur përfshin zbulimin e aspekteve të jetës private ose të të dhënave personale".* Sa më sipër, AMA i tërhoqi vëmendjen operatorit përkatës duke i kërkuar ndërprerjen e menjëhershme të praktikave të tilla, në shkelje të kërkesave ligjore.

Ankesa e paraqitur nga: **M.Sh**

Subjekti audioviziv	Programi	Data
<b>TV "Abc News"</b>	<b>Emisioni "Style Star"</b>	<b>11.04.2022</b>

### 1. Përmbledhje e Ankesës

Shtetasja M.Sh i drejtoi Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) një ankesë, në lidhje me emisionin "Style Star", i transmetuar në televizionin "Abc Neës", në datën 08.04.2022. Ankuesja pretendonte se në emisionin në fjalë, njëri prej anëtarëve të jurisë kishte përdorur shprehje diskriminuese dhe bullizuese ndaj njëres prej konkurrenteve femra, pjesëmarrëse në emision.

### 2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Bazuar në kërkesat e ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, përmbajtja e transmetuar në këtë emision u shqyrtua dhe në të u identifikuan shkelje në fashën kohore 22:21-22:25.

Një prej anëtarëve të jurisë, pjesë e emisionit argëtues, kishte përdorur fjalor krejt të papërshtatshëm, ndaj një konkurrenteje, duke përdorur etiketime fyese dhe denigruese. Nga shqyrtimi i materialit filmik rezultoi se situata kishte dalë nga kontrolli në komunikimin e mëpasshëm, duke prodhuar dialog të tensionuar, pavarësisht ndërhyrjeve të moderatores së emisionit për të qetësuar palët. Fjalori aspak etik, aq me tepër në formën e një sulmi denigrues ndaj një femre konsiderohet i papranueshëm.

Emisioni ishte i regjistruar para se të transmetohej, por kjo nuk ishte shfrytëzuar nga prodhuesi për të shmangur tensionin e krijuar, ashtu siç ishte vepruar me mbulimin zanor të disa fyerjeve në dialogun vijues mes anëtarit të jurisë dhe konkurrentes.

Liria e veprimtarisë audiovizive, hartimi i katalogëve të larmishëm programorë, nuk ka lidhje me përmbajtjet e papërshtatshme, që cenonjë

dinjitetin e pjesëmarrësve e të ndjekësve. AMA i kujtoi OSHMA-së ligjin nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", nenin 4 dhe 33, që përcaktojnë detyrimet e tyre, mes të tjerave dhe detyrimet që duhet "të mos cenonjë dinjitetin dhe të drejtat themelore të njeriut", apo "të respektojnë rregullat e etikës dhe moralit publik...". Gjithashtu, në Kodin e Transmetimit është përcaktuar qartë se: "transmetimet audiovizive respektojnë personalitetin, dinjitetin dhe të drejtat e liritë e tjera themelore të njeriut", (pika 1.3) dhe "veprimtaria e transmetimeve audiovizive respekton normat morale dhe etike të shoqërisë, si dhe kërkesat e deontologjisë së profesionit të gazetarit", (pika 1.6). Bazuar në sa më sipër, AMA i tërhoqi vëmendjen operatorit audioviziv dhe i kërkoi mospërsëritjen e rasteve të tilla; në të kundërt do të kishte procedura administrative sipas legjislacionit në fuqi. Gjithashtu, AMA i rekomandoi heqjen e pjesës së papërshtatshme të emisionit nga versioni i shkarkimit në llogaritë e subjektit në rrjetet sociale dhe në platformën video-sharing në YouTube.

2

Ankesa me  
objekt  
"Cënimin e  
të drejtave  
të femijëve"

Ankesa e paraqitur nga: **N.T**

<u>Subjekti audioviziv</u>	<u>Programi</u>	<u>Data</u>
<b>Report TV</b>	<b>Emisioni "Pa gjurmë"</b>	<b>14.02.2022</b>

### 1. Përmbledhje e Ankesës

N.T, punonjëse për Mbrojtjen e Fëmijëve, në Bashkinë Korçë, iu drejtua me një ankesë Autoritetit të Mediave Audiovizive, në lidhje me emisionin "Pa gjurmë", transmetuar në televizionin "Report TV", më 26.01.2022. Sipas ankueses, "i mituri shprehet se pas publikimit në rrjetet sociale të videos së emisionit nuk ka qenë mirë psikologjikisht... dhe se nuk mund ta përballojë dot faktin që mund të shihet nga të tjerët si fëmija i abuzuar nga gjyshja", ndaj dhe N.T i kërkonte AMA-s heqjen e materialit audioviziv pasi ajo pretendonte se pengon rehabilitimin e viktimës.

### 2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

AMA e shqyrtoi emisionin për të cilën ishte drejtuar ankesa. Nga këqyrja e materialit filmik u evidentua se moderatorja në studio kishte mbajtur një qëndrim të qartë, në mënyrë të përsëritur, që, si nga personi që intervistohet, ashtu dhe nga eksperti ligjor, të tregohej kujdes për mosidentifikimin e emrave të personave apo të vendndodhjeve. Moderatorja deri në fund të bisedës e kërkoi këtë nga të ftuarit në studio përmes ndërhyrjeve. Sa më sipër, AMA nuk gjeti elementë të neglizhencës apo të thyerjes së standardeve të transmetimit, bazuar në ligjin 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore të miratuara në fuqi.

Ankesa e paraqitur nga: **Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës**

<u>Subjekti audioviziv</u>	<u>Programi</u>	<u>Data</u>
<b>TV "Klan"</b>	<b>Edicione informative</b>	<b>16.03.2022</b>

### 1. Përmbledhje e Ankesës

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës i nisi AMA-s një ankesë, pas transmetimit në media të një vajze të vogël, e cila merrte pjesë në protestë. Specialistët e agjencisë i referoheshin televizionit "Klan", por njëkohësisht nënvizonin se të pranishme gjatë fjalës së vajzës në protestë kishin qenë të gjitha mediat të cilat e kishin transmetuar në kohë reale aktivitetin. Sipas ankueses, vajza e vogël ishte "instruktuar nga të rritur dhe përdori gjuhë dhe shprehje të papërshtatshme për moshën e saj". Për këtë arsye, ata kërkuan tërheqjen e vëmendjes ndaj medias për të treguar kujdes në transmetimet, në të cilat janë të përfshirë fëmijë.

### 2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Strukturat përbërëse të Autoritetit të Mediave Audiovizive që trajtuan ankesën e ASHDMF-së i kërkuan kësaj të fundit saktësimin e disa të dhënave shtesë, si: orari i transmetimit, data, nëse transmetimi në fjalë ishte "live" apo gjatë edicioneve informative. Kjo ndihmë kërkohet për të kuptuar nëse prania e fëmijës në protestë ishte problem i organizatorëve apo i OSHMA-ve që e ritransmetonin. Në përgjigjen e tyre, Agjencia nuk mundi të specifikonte orarin e transmetimit dhe për rrjedhojë shqyrtimi i ankesës eidentoi mangësi që penguan vijimin e trajtimit të plotë të saj.

Ankesa e paraqitur nga: **J.M**

Subjekti audioviziv

**TV "Top Channel"**

Programi

**Emisioni "Fiks Fare"**

Data

**17.03.2022**

## 1. Përmbledhje e Ankesës

Shtetasja J.M, i drejtoi një ankesë Autoritetit të Mediave Audiovizive lidhur me emisionin "Fiks Fare", të transmetuar në televizionin "Top Channel" në datë 17.03.2022, ora 20:10. Ankuesja pretendonte se në këtë emision ishin publikuar të dhëna personale të saj dhe se nga mënyra e trajtimit të çështjes nga media mund të ndikonte në proceset gjyqësore.

## 2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Pas marrjes së ankesës, Autoriteti i Mediave Audiovizive shqyrtoi përmbajtjen audiovizive. Duke iu referuar ankesës, Autoriteti i kërkoi OSHMA-së paraqitjen e pretendimeve, bazuar në nenin 51 të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, rregullores "Mbi procedurat për shqyrtimin e ankesave nga Këshilli i Ankesave dhe të drejtës së përgjigjes", si dhe udhëzimit "Mbi procedurat e trajtimit të ankesave nga Ofruesit e Shërbimit Mediatik Audioviziv". Gjithashtu i kujtoi OSHMA-së se, sipas pikës nr.2, të nenit 5 të rregullores "Mbi procedurat për shqyrtimin e ankesave nga Këshilli i Ankesave dhe të drejtës së përgjigjes", afati për paraqitjen e pretendimeve është 7 ditë nga momenti i marrjes së këtij njoftimi.

Edhe pas pritjes së afateve përfundimtare, OSHMA-ja nuk i paraqiti pretendimet për rastin. Ndërkohë, AMA vijoi trajtimin e ankesës, e cila i referohej emisionit "Fiks Fare" të transmetuar në 17.03.2022, në televizionin kombëtar "Top Channel". Në fashën orare 20:31-20:42, në pjesën e dytë të emisionit, ishte trajtuar rasti i familjes së z.K.L. Ky i fundit pretendonte se ish-bashkëshortja e tij ishte dhunuese ndaj

fëmijëve dhe e vërtetonte këtë me një vendim gjyqësor për urdhër mbrojtjeje. Por, pavarësisht kësaj, gjykata kishte vendosur që pas divorcit fëmijët t'i kalojnë nënës.

Gjatë bisedës me gazetaren përmendet emri i ish-bashkëshortes. Gjithashtu, transmetohej një video, ku zonja M. me fëmijën në krahë, e revoltuar, ndodhej në shkallët e pallatit. Por, fëmija dhe nëna shfaqeshin me pamje të sfumuar si dhe nuk identifikoheshin vendbanimi.

Në ligjin 97/2013 "Për median audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në nenin 4, pika 2, germa ç, thuhet se: *"Operatorët e shërbimit audioviziv, gjatë zhvillimit të veprimtarisë së tyre, udhëhiqen edhe nga këto parime: .... respektimi dhe garantimi i së drejtës së ruajtjes së jetës private."*

Neni 33, pika 1, germa dh, ku përcaktohet se OSHMA-të nuk duhet të cenojnë të drejtën e fshehtësisë së jetës private të individit.

Gjithashtu në Kodin e Transmetimit, Seksioni 3 *"E drejta për privatësi dhe mbrojtjen e të drejtave personale"*, pika 3.1 *"ku sigurohet se shpërndarja e informacionit tek publiku për jetën private pa pëlqimin e individit, është e pranueshme vetëm nëse një interes i ligjshëm publik tejkalon të drejtën e tyre për privatësi"*.

Për sa më sipër, AMA i tërhoqi vëmendjen OSHMA-së përkatëse duke i bërë thirrje për mospërsëritjen e rasteve që cenojnë privatësinë dhe mbrojtjen e të drejtave personale në shkelje të Ligjit për Mediat Audiovizive dhe Kodit të Transmetimit.



Ankesa e paraqitur nga: **A.H**

Subjekti audioviziv

**TV Klan**

Programi

**Emisioni "Stop"**

Data

**16.02.2022**

### 1. Përmbledhje e Ankesës

A.H i drejtoi një ankesë Autoritetit të Mediave Audiovizive në lidhje me emisionin "Stop", të transmetuar në televizionin "Klan", në datat 24 dhe 25 Korrik 2017, ora 20:05. Ankuesi pretendonte se emisioni në fjalë kishte trajtuar dhunën e ushtruar ndaj tij nga një shef policie, mirëpo transmetimi i këtyre pamjeve i kishte shkaktuar dëm psikologjik dhe prishje imazhi.

### 2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

AMA pasi u njoh me ankesën, konstatoi se periudha kur kishte ndodhur transmetimi i përmbajtjes audiovizive ishte jashtë afateve që parashikon legjislacioni në fuqi. Bazuar në ligjin 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", neni 52, pika 2: *"Ankesa duhet të paraqitet në formë të shkruar në Këshillin e Ankesave brenda 30 ditëve nga data e transmetimit, ose kur në rastin e dy ose më shumë transmetimeve të lidhura me njëra-tjetrën, nga data e transmetimit më të vonë"*. Sa më sipër, përmbajtja e transmetuar nuk mund të ishte objekt shqyrtimi nga AMA.

Ankesa të  
rrezuara



Ankesa me  
objekt  
jashtë  
juridiksionit  
të ANA-s

Ankesa e paraqitur nga: **D.K**

Subjekti audioviziv

**JOQ**

Programi

**Foto/video**

Data

**29.03.2022**

### 1. Përmbledhje e Ankesës

Shtetasi D.K iu drejtua Autoritetit të Mediave Audiovizive pas publikimit të disa fotove dhe videove të një të mituri në portalin "JOQ". Ankuesi pretendonte se ky portal kishte publikuar "pa aprovimin e prindërve apo edhe të vetë fëmijës në datën 29.03.2022 një video të fëmijës së mitur në rrjetin "Instagram".

### 2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

AMA pasi u njoh me ankesën që lidhej me publikimin e materialit në portalin online por edhe në mediat sociale, i bëri të ditur ankuesit se ankesa e tij ishte jashtë juridiksionit të Autoritetit të Mediave Audiovizive.

Sipas ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ankesa ishte jashtë objektit të punës të përcaktuar nga ligji. Sipas nenit 2 të ligjit të sipërcituar ("**Fusha e zbatimit**"), ky ligj zbatohet për transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre.

Ky ligj nuk zbatohet për median e shkruar, portalet dhe as për rrjetet sociale, pra Autoriteti i Mediave Audiovizive nuk i monitoron dhe as i kontrollon këto portalet/rrjetet sociale.

*Fund*

**AUTORITETI I  
MEDIAVE  
AUDIOVIZIVE**

Adresa: Rruga "Papa Gjon Pali II",  
Nr. 15, Kutia Postare 1010, Tiranë.  
[www.ama.gov.al](http://www.ama.gov.al)



këtej, mbështetur në Kodin  
të miratuar nga A  
e Audiovizive i cili përm  
parimet, rregullat, kërkes  
e transmetimeve audioviz  
ën e Shqipërisë, Këshilli i  
n të vëzhgojë me kujdes se  
të mirëpërcaktuara për p  
etimet audiovizive zbatoh  
i Këshillit të Ankesave i  
kohësh ka qenë i mundur  
audioviziv si këshillues i pë  
meve audiovizive, është n  
të cilin raportohen resul  
vara nëpërmjet të cilave dy  
arimet, rregullat, kërkesat